



Të Reja ▾ Policia e Shtetit ▾ Shërbime ▾ Baza ligjore ▾ Vendndodhjet e policisë ▾ Video ▾ Programi i transparencës ▾ Kontakt

Denonco Krimin Kibernetik ▾ Drejtoritë Vendore të Policisë ▾ Policia Kufitare ▾ Policia Rrugore ▾ Donacione

Rubrika Policimi në Komunitet ▾ Përmbledhja Javore

Lajmet e Fundit: Zv/Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Albert Dervishaj uron fëmijët me rastin e 1 Qershorit, nga Qendra e Zhvillimit "Pëllumbat" ⏮ ⏭ ⏮ ⏭



Lajmet Operacionet

01/06/2022

### Durrës – Finalizohet operacioni policor i koduar “Kulla”

Parandalohet dhe goditet një rast i tentativës për të shitur lëndë eksplozive tritol.

Sekuestrohen 4 kallëpë tritol me peshë të përgjithshme rreth 1 kilogram.

Vihet në pranga poseduesi i tyre, i cili u kap duke transportuar lëndën eksplozive.

Shërbimet e Stacionit të Policisë Manëz, në bashkëpunim me ato të Komisarariatit të Policisë Durrës, në bazë të informacioneve të marra në rrugë operative, se një shtetas po transportonte lëndë eksplozive, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar “Kulla”, në kuadër të të cilit u arrestua në flagrancë shtetasi:

-R. K., 19 vjeç, banues në fshatin Kullë, Durrës.

Ky shtetas u kap në aksin rrugor Sukth – Kullë, duke transportuar me qëllim shitjen, 4 kallëpë lëndë eksplozive tritol, me peshë të përgjithshme rreth 1 kilogram.

Vijon puna, në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për zbardhjen e plotë të këtij rasti, si dhe të implikimit ose jo në ngjarje kriminale, të 19-vjeçarit.

Materialet e para hetimore në ngarkim të këtij shtetasi, i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, për veprime të mëtejshme.

WhatsApp Share Facebook Share Twitter Share LinkedIn Share Email


◀ Kukës – Finalizohet me sukses operacioni policor i koduar “Thirra”

Fier – Finalizohet operacioni policor i koduar “Vazhdimësia” ▶

Kërko

Enter a word for search 🔍

Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)